

VENDIM
Nr. 124, datë 30.5.2025

AUTORIZIM I NDIHMËS SHTETËRORE “PËR PROJEKTIMIN, FINANCIMIN, NDËRTIMIN, MARRJEN NË PRONËSI, SHFRYTËZIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE TRANSFERIMIN E PROJEKTIT TË HIDROCENTRALIT NË LUMIN DEVOLL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Komisioni i Ndihmës Shtetërore me pjesëmarrjen e:

- Z. Blendi Gonxhja kryetar;
- Znj. Mimoza Dhëmbi anëtare;
- Z. Besnik Çina anëtar;
- Znj. Keida Qirko anëtare;
- Z. Ahmet Maqcellari anëtar,

në mbledhjen e tij të radhës të datës 30.5.2025, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005, “Për miratimin e rregullores ‘Për procedurat dhe formën e njoftimit’”, morri në shqyrtim njoftimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të planit të ndihmës shtetërore për projektin “Për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit të hidrocentralit në lumin Devoll në Republikën e Shqipërisë”.

I. Procedura

1. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me shkresën nr. 5312, datë 20.6.2024, “Mbi dhënien e autorizimit të ndihmës shtetërore projektit hidroenergjetik të Devollit”, në bazë të nenit 20, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”; Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit me shkresën nr. 8194/1, datë 20.9.2024, kërkoi të dhëna të detajuara mbi njoftimin e sipërcituar; MIE me shkresën nr. 5312/2, datë 6.1.2025 paraqiti të dhënat shtesë referuar projektit Hidroenergjetik të Devollit.

II. Përshkrimi i masës

II.1 Kuadri strategjik në sektorin e hidroenergjisë për prodhimin e energjisë elektrike

2. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 480, datë 31.7.2018, “Për miratimin e strategjisë kombëtare të energjisë për periudhën 2018–2030” (Strategjia), është përcaktuar që ky dokument vjen si rrjedhojë e reformave të guximshme dhe të vështira që ndërmori qeveria shqiptare në sektorin e energjisë elektrike, një reformë të thellë, produktet e së cilës tanimë janë të dukshme. Si një nga pikat kryesore të këtyre treguesve është theksuar ndërtimi i rreth 400 mw kapacitete të reja gjeneruese të energjisë elektrike në fushën e HEC-eve të vogla dhe kaskadës shumë të rëndësishme të Devollit me HEC-in e Banjës, tashmë të vendosur në operim që prej më shumë se një viti dhe HEC-in e Moglicës që është në fazën finale të ndërtimit.

3. Sipas Strategjisë përcaktohet se historikisht, gjenerimi i energjisë elektrike është përmbushur pothuajse ekskluzivisht nga hidrocentralet, me një kapacitet total të instaluar prej 2,011 mw në fund të vitit 2016. Vendi ka shfrytëzuar afro 50% të potencialit të vet hidroenergjetik dhe zgjerimi i ardhshëm i kapacitetit hidroenergjetik është i mundur kryesisht përgjatë lumenjve Drin, Mat, Devoll dhe Bistricë.

4. Kapacitetet hidrike janë burimet natyrore të rinovueshme më të rëndësishme të energjisë për prodhimin e energjisë elektrike në vendin tonë. Shqipëria importon energji elektrike nga vendet fqinje, megjithëse importet kanë rënë në mënyrë progresive në dhjetë vjetët e fundit pas rritjes së prodhimit të brendshëm të energjisë elektrike dhe zvogëlimit të humbjeve të energjisë elektrike (teknike dhe

joteknike) në sistemin e shpërndarjes, të cilat janë zvogëluar nga 45.04% më 2013-n në 25.04% deri në fund të vitit 2016 me një plan të qartë investimesh dhe menaxhimi për t'i ulur ato më tej në 17% deri në fund të 2020-s.

5. Parimet që udhëheqin zhvillimin e kësaj strategjie të energjisë janë në përputhje me objektivat e SKZHI-II, në mënyrë specifike, për:

- rritjen e sigurisë së furnizimit me energji, ndërsa sigurohet rritje në mirëqenie;
- zhvillimi i burimeve kombëtare të energjisë, diversifikimi i burimeve të furnizimit dhe ndërlidhja me rrjetet evropiane të energjisë elektrike dhe gazit natyror në përputhje me *acquis* të Traktatit të Komunitetit të Energjisë;
- krijimi i një tregu konkurrues që ofron sinjale korrekte për prodhimin dhe konsumin e energjisë elektrike dhe gazit natyror;
- ofrimin e incentivave për zbatimin e politikave të nevojshme të ndryshimeve klimatike, të tilla si arritjen e objektivave të BRE-së dhe të eficiencës së energjisë dhe për uljen e shkarkimeve të CO₂ dhe zbatimin e objektivave të KKE (NDC), në kuadër të UNFCCC-së.

6. Objektivat strategjikë afatgjatë, në vijim, janë identifikuar për të realizuar parimet udhëzuese dhe angazhimet aktuale që janë ndërmarrë nga qeveria shqiptare:

- përmirësimi i besueshmërisë dhe sigurisë së furnizimit me energji;
- zhvillimi i burimeve të brendshme të energjisë primare në një mënyrë të qëndrueshme dhe konkurruese;
- përmirësimi i efektivitetit të kostove të sistemeve të furnizimit me energji;
- arritja e objektivave për burimet e rinovueshme të energjisë dhe eficiencën e energjisë të përcaktuara në Planet Kombëtare të Veprimit për Eficiencën e Energjisë dhe për Burimet e Rinovueshme të Energjisë;
- zhvillimi i politikave dhe strategjive me kosto efektive për rritjen e performancës së energjisë në ndërtesat publike dhe ato rezidenciale;
- integrimin e tregut shqiptar të energjisë elektrike dhe të gazit natyror me Kosovën, rajonin dhe tregjet evropiane; dhe
- arritjen e objektivave të Kontributit Kombëtar të Përcaktuar (NDC) për reduktimin e emetimeve të gazrave me efekt serë (GHG).

II.II Plani i investimit të Projektit Hidroenergjetik të Devollit

7. Kontrata e koncesionit “Për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Projektit të Hidrocentralit në Lumin Devoll, në Republikën e Shqipërisë”, është miratuar me ligjin nr. 10083, datë 23.2.2009. Kontrata e Koncesionit është ndryshuar në vijim me shtesën I të miratuar me ligjin nr. 10337, datë 21.10.2010, shtesa II të miratuar me ligjin nr. 105/2013, shtesën III të miratuar me ligjin nr. 7/2015 dhe shtesën IV të miratuar me ligjin nr. 83/2023.

8. Projekti i hidrocentraleve në lumin Devoll vlerësohet si një investim strategjik. Projekti Hidroenergjetik i Devollit konsiston në projektimin, planifikimin, ndërtimin dhe operimin e dy hidrocentraleve, HEC Banja dhe HEC Moglicë, me një kapacitet të instaluar prej rreth 269 mw dhe prodhim të rreth 700 gwh/vit. Vendimi për investimin e një hidrocentrali të tretë, HEC Kokël, do të shqyrtohet pas përfundimit të dy hidrocentraleve të parë. Ky projekt vlerësohet të sjellë rritje me 20% të prodhimit të energjisë elektrike, duke ndikuar në përmirësimin e bilancit valutor dhe tregtar të vendit. Projekti siguron furnizim më të mirë dhe me kosto të përshtatshme të energjisë për popullsinë, rritje të punësimit, përmirësim të sistemit rrugor etj.

9. Projekti filloi aktivitetet e para në terren në kuadër të fazës parandërtimore në vitin 2009, pas miratimit nga Parlamenti Shqiptar të Kontratës së Koncesionit. Në vitin 2013 filloi ndërtimi i HEC Banja, i cili përfundoi dhe hyri në operim në vitin 2016. Ndërtimi i HEC Moglicë filloi në vitin 2015

dhe operimi i hidrocentralit filloi në vitin 2020. Kostoja e investimit të Projektit Hidroenergjetik të Devollit është vlerësuar rreth 590 milionë euro. Ky investim ka sjellë impakt pozitiv në ekonominë e vendit dhe atë rajonale. Nga zbatimi i kësaj kontrate, për banorët e zonës janë aplikuar programe sociale strehimi dhe krijimi i infrastrukturës së nevojshme. Numri i të punësuarve, në fazën e zbatimit të projektit, ka qenë rreth 2000 punëtorë, ku shumica prej tyre kanë qenë të punësuar nga kontraktorët e Devoll Hydropower sh.a. (DHP). Gjithashtu, në zbatim të Shtesës së Tretë të Kontratës së Koncesionit, koncesionari mori përsipër të projektojë, tenderojë dhe ndërtojë Infrastruktura Zëvendësuese kundrejt një kompensimi të drejtë dhe të kënaqshëm për shpenzimet shtesë të saj. Infrastruktura zëvendësuese përfshinte ndërtimin e rrugës zëvendësuese Banja – Gramsh, Ura e Trashovicës, rruga zëvendësuese Moglicë M15 dhe rruga zëvendësuese Moglicë M03, të cilat janë përfunduar nga koncesionari dhe i janë dorëzuar Autoritetit Rrugor Shqiptar, në cilësinë e entit shtetëror dhe në përputhje me marrëveshjen mes palëve.

10. Qëllimi i njoftimit të planit të ndihmës është:

Së pari, përmbushja e detyrimeve ligjore të parashikuara në:

- Shtesën nr. 2, paragrafi 4, Miratimi nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore:

“Autoriteti Kontraktues konfirmon që Komisioni shqiptar i Ndihmës Shtetërore ka miratuar termat dhe kushtet e Kontratës së Koncesionit dhe të kësaj Shtese të 2-të.”

- Shtesën nr. 3, paragrafi 4, Miratimi nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore:

“Autoriteti Kontraktues konfirmon se Komisioni i Ndihmës Shtetërore shqiptare ka miratuar afatet dhe kushtet e Kontratës së Koncesionit dhe këtë Shtesë të 3-të.”

- Shtesën nr. 4, paragrafi 6, Miratimi nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore:

“Autoriteti Kontraktues konfirmon dhe bën të ditur që Komisioni shqiptar i Ndihmës Shtetërore shqiptare ka miratuar termat dhe kushtet e kësaj shtese të 4-t dhe/ose ka konfirmuar se nuk ka element të ndihmës shtetërore.”

Së dyti, shoqëria koncesionare ka rezultuar fituese e procesit konkurrues për zhvillimin e Projektit, si pjesë e masave të parashikuara për zhvillimin e sektorit të prodhimit të energjisë elektrike. Zhvillimi i Projektit ka rezultuar në një rritje të ndjeshme të prodhimit vendës të energjisë elektrike, duke ndikuar në përmirësimin e treguesve në lidhje me energjinë duke ndikuar në arritjen e objektivave sipas strategjive dhe planeve kombëtare, si dhe ka nxitur konkurrencën në tregun e energjisë elektrike, duke rritur eksportet e energjisë së prodhuar në Shqipëri.

III. Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore

11. Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson nëse plani i ndihmës shtetërore përbën ndihmë shtetërore në kuptim të paragrafit 1, të nenit 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, pra nëse plani ofron një avantazh ekonomik për ndërmarrje, e cila ka një ndikim të mundshëm në konkurrencë dhe tregtinë midis shteteve anëtare, që nuk do të ishte përfituar në kushte normale të tregut.

12. Neni 4, pika 1 e ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, përcakton se:

“Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdoq formë e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara, për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarra nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore”.

13. Gjithashtu, neni 71 “Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike”, i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane e Shteteve të tyre Anëtare dhe Republikës së Shqipërisë¹ përcakton se:

¹ Ligji nr. 9590, datë 27.7.2006, “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së stabilizim-asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve evropiane e shteteve të tyre anëtare”.

“Praktikat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kritereve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës të aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit.”

14. Ligji i ndihmës shtetërore zbatohet vetëm për masat që plotësojnë të gjitha kriteret e përmendura në nenin 4, pika 1, konkretisht: a) burime shtetërore; b) avantazhi ekonomik; c) selektiviteti; dhe d) efekti në konkurrencë dhe treg.

14.1 Burimet shtetërore

Sipas ligjit nr. 9374/2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar “Burime shtetërore” janë burimet e Buxhetit të Shtetit, përfshirë të drejtat dhe detyrimet ndaj të tretëve, titujt shtetërorë, fondet publike, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, burimet e buxhetit të njërive të qeverisjes vendore, burimet e shoqërive shtetërore, në rastet kur këto burime nuk aktivizohen në përputhje me parimin e investitorit privat në një ekonomi tregu. Në këtë kuptim, dhënia, të drejtave të veçanta ose ekskluzive që kanë një vlerë ekonomike, mund të nënkuptojë heqjen dorë nga burimet shtetërore dhe të krijojë një avantazh për përfituesit.

Komponenti 1

Neni 2.4.3 (a) i Kontratës së Konkensionit (miratuar me ligjin 10083, datë 23.2.2009) parashikon si vijon:

“Në çdo kohë gjatë afatit, autoriteti kontraktues do të:

a) zhdëmtojë shoqërinë koncesionare dhe koncesionarin nga përgjegjësitë ose kostot që lindin nga vendosja ose një rritje e Taksave e cila:

i. e bën atë taksë specifike 20% më të lartë se mesatarja e parashikuar (e parashikuar mbi bazën e GDP-së së vendeve anëtare) e asaj takse specifike brenda Bashkimit Evropian; ose

ii. shkakton, individualisht ose në total me rritjet dhe zbritjet e akumuluar të taksave të tjera që ishin vendosur ose që kishin lindur pas datës së hyrjes në fuqi, kostot vjetore shtesë për Projektin, prej 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) euro ose më shumë, kur krahasohen me kostot që do të ishin pësuar nëse do të ishin aplikuar normat e taksës që kishin qenë në fuqi që nga data e hyrjes në fuqi;

Për qëllime të këtij paragrafi (a), fjala “taksa” nuk do të përfshijë (x) taksat e arsyeshme, detyrime, tatime, tarifa, pagesa, taksa doganore ose tarifa të çdo lloji që paguhen në këmbim të një përfitimi të drejtpërdrejtë ekuivalent të një të drejte, shërbimi, licence ose titulli tjetër të koncesionari dhe (y) kontributet për sigurimin e detyrueshëm shoqëror dhe sigurimin shëndetësor.

Ndërsa në nenin 2.4, i shtesës së 3-të, të Kontratës së Konkensionit (miratuar me ligjin nr. 7/2015, datë 12.02.2015), përcaktohet se:

“Në nenin 2.4.3 shkronja (a) pika (i) fjalët “20%” do të fshihen, me efekt për rritjet e taksave që ndodhin mbas datës efektive të kësaj shtese të 3-të.”

Komponenti 2

Bazuar në nenin 2.2.1. të Kontratës së Konkensionit, parashikohet se:

“1.2.1 Që nga data e hyrjes në fuqi, Autoriteti Kontraktues i jep koncesionarit, i cili i pranon, të drejtat ekskluzive për të gjithë afatin, në mënyrë që:

“d) shesë dhe furnizojë prodhimin neto të energjisë elektrike brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe mbledhë dhe mbajë të ardhurat nga këto shitje, me kusht që:

i. koncesionari të veprojë në përputhje me legjislacionin në fuqi për prodhimin, transmetimin dhe shitjen e energjisë gjatë vazhdimësisë së këtij aktiviteti; dhe

ii. koncesionari të plotësojë kërkesat e Autoritetit Kontraktues ose të Rregullatorit për të vepruar sipas detyrimeve të shërbimit publik, siç është përcaktuar në nenin 25, të ligjit nr. 9072, datë 22 maj 2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, me kusht që koncesionari të kompensohet nga Autoriteti Kontraktues për ndonjë rënie në të ardhura ose rritje në kosto të cilat ai mund t’i pësojë, për shkak të përmbushjes së këtyre detyrimeve,

ose për shkak të ndonjë kufizimi tjetër ligjor të cilat ndalojnë koncesionarin të shesë ose eksportojë ndonjë pjesë të prodhimit neto të energjisë elektrike, brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.

Bazuar në pikën 2.3, të shtesës së 3-të të Kontratës së Koncesionit, parashikohet se pika (ii) e paragrafit (d) të nenit 2.2.1 të Kontratës së Koncesionit, ndryshohet si vijon:

“ii. Koncesionari të plotësojë kërkesat e Autoritetit Kontraktues ose të Rregullatorit për të vepruar sipas detyrimeve të shërbimit publik, siç përcaktohet aktualisht në nenin 25 të ligjit nr. 9072 datë 22 maj 2003 “Për sektorin e energjisë”. Koncesionari do të kompensohet brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga Autoriteti Kontraktues për ndonjë rënie në të ardhurat ose rritje në kosto, të cilat ai mund t'i pësojë për shkak të përmbushjes së këtyre detyrimeve ose për shkak të ndonjë kufizimi tjetër ligjor të cilat ndalojnë koncesionarin të shesë ose eksportojë ndonjë pjesë të prodhimit neto të energjisë elektrike, brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë. Në rast se Autoriteti Kontraktues nuk paguan shpërblim për ndonjë kërkesë për rënie në të ardhura dhe/ose rritje të kostove, që duhet t'i paguhen koncesionarit dhe kjo gjë nuk është korrigjuar brenda (45) ditësh, pasi është dërguar njoftimi me shkrim për uljen e të ardhurave dhe/ose rritjen e kostove tek Autoriteti Kontraktues, *koncesionari ka të drejtë të kompensojë çdo tarifë koncesioni të pagueshme sipas nenit 4.1 të Kontratës së Koncesionit dhe çdo e të gjitha taksat e pagueshme kundrejt shpërblimit të lartpërmendur, në përputhje me parimet e nenit 7.2.7.6; dhe*”.

Mbështetjet financiare të parashikuara në referencat ligjore të sipërcituara nëpërmjet:

a) *zhdëmtimit* të shoqërisë koncesionare dhe koncesionarit nga përgjegjësitë ose kostot që lindin nga vendosja ose një rritje e taksave);

b) *kompensimit* brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga Autoriteti Kontraktues për ndonjë rënie në të ardhurat ose rritje në kosto, të cilat ai mund t'i pësojë për shkak të përmbushjes së këtyre detyrimeve, ose për shkak të ndonjë kufizimi tjetër ligjor të cilat ndalojnë koncesionarin të shesë ose eksportojë ndonjë pjesë të prodhimit neto të energjisë elektrike, brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë,

aktivizojnë burime shtetërore, të cilat do të lehtësojnë ndërmarrjen për mbulimin e shpenzimeve të cilat normalisht do të duhej të përballohen nga burimet të veta të saj dhe për këtë arsye ndërmarrja përfiton një avantazh ekonomik ndaj konkurrentëve të tij.

14.2 Avantazhi ekonomik

Masa i jep ndërmarrjes të drejtën të ndërtojnë dhe shfrytëzojnë investimin kundrejt skemës së zhdëmtimit dhe atë të kompensimit, duke i dhënë një avantazh ndërmarrjes për të kryer investimet për projektin me objekt: *ndërtimi, prodhimi dhe tregtimi i energjisë elektrike.*

14.3 Selektiviteti

Masa lidhet me skemën e zhdëmtimit dhe të kompensimit të projektit të ndërtimit të dy hidrocentraleve në lumin Devoll, e cila është selektive, pasi favorizon një ndërmarrje që operon në sektorin e energjisë.

14.4 Efekti në konkurrencë dhe treg

Siç referohet në njoftim, bazuar në detyrimet që derivojnë nga zbatimi Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA), në këtë plan parashikohej se prioritetet afatmesme (2008–2009) për fushën e energjisë janë:

- *Zbatimi në kohë i projekteve të ndryshme që synojnë përmirësimin e infrastrukturës për prodhimin e energjisë, transmetimin dhe shpërndarjen.*

- *Vazhdimi i zbatimit të angazhimeve rajonale dhe ndërkombëtare në fushën e energjisë, me objektin ngritjen e një tregu konkurrues rajonal të energjisë.*

Duke konsideruar dimensionin ndërkombëtar të funksionimit të aktivitetit ekonomik në sektorin e energjisë, përfshirë ndërtimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e rrjetit të energjisë elektrike, si dhe numrit të operatorëve aktivë në këtë sektor, Komisioni vlerëson se masa ka ndikim në tregun vendës dhe ndërkombëtar.

Në këto kushte, Komisioni vlerëson se plani i njoftuar është ndihmë shtetërore, e cila në bazë të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, është e ndaluar, përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj.

IV. Ligjshmëria e ndihmës

15. Komisioni vlerëson se MIE ka përmbushur detyrimin e saj sipas nenit 4, të ligjit nr. 9374/2005 “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar duke e njoftuar masën përpara zbatimit të saj, duke e njoftuar masën në Komisionin e Ndihmës Shtetërore.

V. Vlerësimi i përputhshmërisë së skemës

16. Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson skemën e njoftuar si vijon:

- *Lidhur me skemën e zhvendësimit të shoqërisë koncesionare dhe koncesionarit nga përgjegjësitë ose kostot që lindin nga vendosja ose një rritje e taksave.*

Bazuar në nenin 14, të ligjit nr. 9374/2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, ndihma rajonale mund të lejohet:

- Nëse ajo mbulon deri në 50% të vlerës së investimit fillestar ose të kostos së pagave të punonjëse për dy vjet për vendet e reja të punës.

- Investimi dhe vendet e reja të punës duhet të ruhen për një periudhë prej pesë vjetësh. Në çdo rast, intensiteti i ndihmës nuk duhet të kalojë 75% të vlerës.

Bazuar në VKM-në nr. 815, datë 28.12.2005, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës rajonale’”, masa e njoftuar përfshihet si një projekt investimi i realizuar me kostot e pranueshme për ndihmën për investim për zhvillimin e projektit hidroenergetik të Devollit, në shumën 590 000 000 (pesëqind e nëntëdhjetë milionë) euro. Kosto e investimit të projektit përfshin si vijon:

- Kostoja për dy hidrocentralet: në Banjë dhe Moglicë;
- Kostoja e linjave të transmetimit që lidhin këto hidrocentrale me rrjetin kombëtar të transmetimit;
- Kostot mjedisore dhe sociale.

Në këtë rast, ndërmarrja ka detyrimin të ruajë investimi në rajon për të paktën 5 (pesë) vjet pas përfundimit të projektit dhe se ka kontribuar me një kontribut financiar prej të paktën 25% të kostove të pranueshme në një formë që nuk ka asnjë mbështetje publike. Kostoja e investimit të Projektit Hidroenergetik të Devollit është vlerësuar rreth 590 milionë euro, nga ku kosto e ndërtimit për të dyja HEC-et është 529 milionë euro: 191 milionë euro HEC Banjë dhe 338 milion euro HEC Moglicë. Intensiteti i ndihmës është 1.56%, në përputhje me pikën 5, të vendimit të KNSH-së nr. 43, datë 11.9.2012, “Për miratimin e hartës rajonale të ndihmës shtetërore”, që përcakton, se: “*në rajonet e nivelit NUTS II, intensiteti i ndihmës rajonale nuk duhet të kalojë 50% të ENG-së*”.

- *Lidhur me skemën e kompensimit për ofrimin e shërbimit publik*

Në përputhje me nenin 13/3, “Ndihma për shërbimet e interesit të përgjithshëm ekonomik”, të ligjit nr. 9374/2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, ku parashikohet, se: “*Ndihma për shërbimet e interesit të përgjithshëm ekonomik është ndihma në formën e kompensimit, e cila u jepet ndërmarrjeve të ngarkuara për kryerjen e shërbimeve me interes të përgjithshëm publik dhe ekonomik.*” Bazuar në VKM-në nr. 650, datë 14.9.2016, “Për përcaktimin e kriterëve, intensitetit dhe të procedurës për dhënien dhe autorizimin e ndihmës shtetërore në formën e kompensimit të shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik dhe publik”, mandati i shërbimit publik duhet të përmbajë, në veçanti:

a) Përmbajtjen dhe përcaktimin sa më të detajuar të detyrimeve të shërbimit publik dhe, kur është e mundur, listën e shërbimeve publike që ndërmarrja përfituese duhet të kryejë;

b) Ndërmarrjen përfituese dhe territorin në të cilin duhet të ofrohet shërbimi publik;

c) Kohëzgjatjen e detyrimeve të shërbimit publik. Në parim, mandati nuk e kalon një periudhë dhjetëvjeçare, përveç rasteve kur ofruesi i shërbimit detyrohet ose angazhohet të kryejë një investim

të rëndësishëm, të papërdorshëm, i cili ka nevojë të amortizohet për një kohë më të gjatë, në përputhje me parimet kontabël përgjithësisht të pranuar;

ç) Mekanizmin e kompensimit dhe të parametrave për llogaritjen, monitorimin dhe rishikimin e kompensimit. Parametrat për llogaritjen e kompensimit duhet të jenë objektivë dhe të matshëm;

d) Masat për shmangien dhe kthimin e çdo mbikompensimi;

dh) Çdo të drejtë ekskluzive apo të veçantë që i është caktuar ndërmarrjes, të cilat duhet të parashikohen paraprakisht me ligj.

Dhënia e ndihmës shtetërore në formën e kompensimit për shërbime publike duhet të jetë proporcionale dhe shuma e kompensimit për shërbime publike nuk duhet të kalojë koston neto të ofrimit të shërbimit publik, përfshirë dhe një marzh fitimi të arsyeshëm.

Për sa më sipër, dhënësi i ndihmës duhet të vlerësojë masën e kompensimit për koncesionarin për shërbimet publike të ofruara.

17. Sa më lart, Komisioni vlerëson se plani i ndihmës shtetërore është i lejueshëm në përputhje me nenin 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në bazë të nenit 4, 20, dhe 31 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë skemën e ndihmës shtetërore “Për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit të hidrocentralit në lumin Devoll në Republikën e Shqipërisë”, të njoftuar në bazë të ligjit nr. 10083, datë 23.2.2009, “Për miratimin e kontratës së koncesionit ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoritet kontraktues, dhe AVN AG, Statkraft AS dhe Devoll Hydropower sh.a., si bashkëkoncesionare, për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit të hidrocentralit në lumin Devoll në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë brenda datës 31 mars të çdo viti të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar. Intensiteti i ndihmës nuk duhet të kalojë 50%. Përveç kostove të pranueshme, të lidhura me investimin në llogaritjen e intensitetit do të merren parasysh të gjitha përjashtimet apo lehtësimet nga taksat, si dhe të gjitha format e tjera të ndihmës.

3. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të njoftojë çdo ndryshim të planit të ndihmës, në përputhje me nenin 21, të ligjit 9374/2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar.

4. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të ruajë deri në dhjetë vjet të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës, pasi ndihma e fundit të jetë dhënë në kuadër të këtij plani.

5. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONI I NDIHMËS SHTETËRORE

Kryetar: Blendi Gonxhja

Anëtarë: Mimoza Dhëmbi, Besnik Çina, Keida Qirko, Ahmet Mançellari